




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE  
TË MINISTRISË SË MJEDISIT PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE  
INFRASTRUKTURËS PËR VITIN 2023**

**Prishtinë, qershor 2024**

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Regjistri i pasurive kapitale i prezantuar në PFV ishte mbivlerësuar për 39,019,617€ si pasojë e gabimeve në regjistrimin e pasurive kapitale dhe mosaplikimit të zhvlerësimit për projekte të përfunduara, si dhe regjistri i pasurive jo kapitale ishte nënvlerësuar për 380,558€ si pasojë e mos regjistrimit të pasurive jo kapitale;
- B2 Detyrimet kontingjente të prezantuara në PFV ishin për nënvlerësuar për 16,534,867€;
- B3 Shpenzimet ishin keq klasifikuar në vlerë prej 7,810,603€, duke ndikuar në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive jo adekuate;
- B4 MMPHI kishte realizuar pagesa në vlerë 398,164€ për 62 të punësuar për të cilët nuk kishte evidenca të vijueshmërisë në punë.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Në kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- B5 Ministria përkundër rregullave ka aplikuar pragun apo tavanin plus/minus tridhjetë përqind (30%) për pozicione të kontratat me çmim për njësi. Kjo ka rezultuar me tejkalim të vlerës së këtyre pozicioneve për 1,192,115€ (në vlerë të përbashkët);
- B6 Në tetë (8) kontrata ishin bërë ndryshime të sasive të kontraktuara duke rritur/zvogëluar sasinë e realizuar pa aprovime paraprake dhe si rezultat tejkalimet e sasive ishin në katër (4) deri 86 pozicione apo në vlerë prej 5,881€ deri në 698,506€ (pa u tejkaluar vlera e kontratës);
- B7 Në dy raste kemi evidentuar ndryshime të kushteve kontraktuale duke mos zbatuar dispozitat ligjore;
- A1 Në dy raste kemi evidentuar mangësi në procesin e vlerësimit të ofertave.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Sekretari i Përgjithshëm është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

### **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve.

Fushat që kërkojnë më tepër fokus janë çështjet me ndikim në opinionin financiar që kryesisht lidhen me një paraqitje jo të saktë të shpalosjeve përkatësisht gjendjes së pasurisë, obligimeve dhe detyrimeve kontigjente. Sa i përket fushës së shpenzimeve edhe këtë vit janë evidentuar raste të keq klasifikimit të shpenzimeve si dhe kompensimi i të punësuarve në mungesë të evidencave të vijueshmërisë në punë.

Sa i përket pajtueshmërisë me legjislacionin dhe rregulloret e zbatueshme, fokus i veçantë duhet t'i kushtohet menaxhimit të kontratave për mirëmbajtje të rrugëve duke evituar tejkalmimet e vlerave të lejuara të shpenzimit si dhe ndryshimit të kushteve kontraktuale. Veprime shtesë janë të domosdoshme edhe në menaxhimin dhe implementimin e projekteve kapitale lidhur me vonesat në realizimin e tyre.

Në kontekst të pagesave, duhet parandaluar shpenzimet përmes vendimeve gjyqësore që kryesisht kanë të bëjnë me konteste të shpronësimit, të cilat në vazhdimësi po i shkaktojnë ministrisë kosto shtesë për kamatë dhe shpenzime gjyqësore. Masa konkrete duhet të merren edhe tek menaxhimi më i mirë llogarive të arkëtueshme, përkatësisht të sigurohen mekanizma efikas për vlerësim dhe arkëtim të borxheve që i kontribuojnë rritjes së të hyrave.

Gjetjet dhe rekomandimet kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik.

Ky raport ka rezultuar me 15 rekomandime, prej tyre tre (3) janë rekomandime të reja dhe 12 rekomandime të përsëritura. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja B1 - Mangësi në procesin e regjistrimit të pasurive

**Gjetja** Neni 10 i Rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton se "Të gjitha pasuritë jo financiare pas pranimit në pronësi dhe mbikëqyrje të organizatës buxhetore, pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara, duhet të regjistrohen në regjistrat kontabël dhe të jenë objekt i inventarizimit dhe i vlerësimit". Neni 11.3 përcakton se "Pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësisht të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi". Tutje, neni 6.3 i kësaj rregulloreje përcakton: "Pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria".

Ne kemi identifikuar disa mangësi sa i përket regjistrimit të pasurive, të cilat kanë ndikuar që regjistri i pasurive kapitale të mbivlerësohet për 39,019,617€ si pasojë e gabimeve në regjistrimin e pasurive kapitale, si dhe regjistri i pasurive jo kapitale të nënvlerësohet për 380,558€ si pasojë e mos regjistrimit të pasurive jo kapitale.

Mangësitë e identifikuar përfshijnë:

- Projekti “Autostrada R6 Prishtinë - Hani i Elezit” ishte regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale si projekt i përfunduar me 25.09.2020, përderisa raporti për përfundimin e këtij projekti ishte bërë në tetor 2019. Rrjedhimisht, vlera neto në librin e pasurive ishte mbi vlerësuar për efektin e mos aplikimit të zhvlerësimit prej 32,805,672€. Deri në vitin 2023 kjo pasuri ka qenë e regjistruar si investim në vijim, dhe për të njëjtin është dhënë rekomandim në vitin e kaluar;
- Në katër (4) raste<sup>5</sup>, pagesat në vlerë 1,695,430€ për projekte të ndryshme kapitale nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive kapitale të cilat kanë shkaktuar nënvlerësim të pasurive kapitale për vlerën e njëjtë;
- Ministria vazhdon t'i mbajë si investime në vijim tre (3) projekte kapitale në vlerë totale 8,144,161€, të cilat kanë përfunduar dhe është bërë pranimi teknik i tyre. Si rezultat i regjistrimit të tyre në klasën joadekuate dhe mos aplikimit të zhvlerësimit, pasuria ishte e mbivlerësuar në efektin neto për 1,438,875€;
- Në regjistrin e pasurive kapitale vazhdon të jetë e regjistruar gabimisht një pagesë e blerjes së pasurive jo kapitale (nën 1,000€) duke e mbivlerësuar regjistrin për vlerën neto të pasurisë për 221,000€. Kjo çështje ishte trajtuar edhe në raportin e vitit paraprak; dhe
- 11 pagesa për blerjen e pajisjeve të IT dhe pajisjeve tjera në vlerë 159,588€ nuk ishin regjistruar në sistemin e-pasuria duke shkaktuar nënvlerësim të pasurive jo kapitale për këtë vlerë (prej tyre 6 pagesa ishin të vitit 2022).

Tutje, rregullorja Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare ka përkufizuar pasuritë kapitale dhe jo kapitale, si dhe ka përcaktuar shpenzimet kapitale si “Pagesa për përvetësimin e pasurive kapitale fikse, për stoqe strategjike ose emergjente, për tokë ose pasuri të paprekshme, ose pagesa të pakthyeshme me qëllim që t'u mundësohet pranuesve t'i përvetësojnë (blejnë) këto pasuri, që të kompensohen pranuesit për dëm ose shkatërrim të pasurive kapitale, ose që të rritet kapitali financiar i pranuesve, në vlerë mbi 1,000€ dhe afat të përdorimit më të gjatë se një vit”. Udhëzimi administrativ 04/2019 për definimin e projekteve kapitale, kapitalizmin e asetit e përkufizon “Regjistrimi i asetit në regjistrin e pasurisë dhe regjistrin kontabël me vlerën e investuar (duke përjashtuar shpenzimet e palejuara)”.

Lidhur me këtë, kemi identifikuar se, si rrjedhojë e regjistrimit të shpenzimeve si pasuri kapitale të cilat nuk i plotësonin kriteret e shpenzimeve kapitale, regjistri i pasurive kapitale ishte mbivlerësuar për 6,249,500€. Përkatësisht, kjo kishte ndodhur te rastet:

- Në 11 raste në vlerë prej 3,338,277€, që kishin të bënin me shpenzimet për interesin e aplikuar për vonesat në kryerjen e kompensimeve të vlerës së tokës së shpronësuar bazuar në vendimet gjyqësore/përmbarrimore. Kapitalizmi i interesit në regjistrin

e pasurive ishte dukuri për të gjitha rastet ku pagesa e shpronësimeve është bërë bazuar në vendimet gjyqësore/përmbartimore; dhe

- Po ashtu, dy pagesa në vlerë 2,991,223€, përmes vendimeve gjyqësore, kishin të bënin me kompensimin e dëmit dhe fitimin e humbur të shkaktuar nga procesi i shpronësimeve. Të njëjtat nuk i takojnë kategorisë së pasurive.

Kjo gjendje ishte për shkak të pakujdesisë dhe mos funksionimit të kontrolleve të brendshme në procesin e menaxhimit të pasurive si dhe mungesës së njohurive lidhur me kapitalizmin e shpenzimeve në procesin e regjistrimit të pasurive.

#### **Ndikimi**

Gabimet në regjistrimin e pasurive, mos regjistrimi i tyre në klasën e duhur si dhe kapitalizmi i shpenzimeve të cilat nuk i plotësojnë kriteret e shpenzimeve kapitale ka ndikuar në mbivlerësimin/nënvlerësimin e regjistrave të pasurive si dhe paraqet prezantim jo të drejtë dhe jo të saktë të pasurive në PFV.

#### **Rekomandimi B1**

Ministri duhet të shtojë kontrollet në regjistrimin e pasurive si dhe të siguroj që departamentet përkatëse të bashkëpunojnë me zyrtarin e pasurive për të identifikuar të gjitha projektet e përfunduara, në mënyrë që pasuritë të regjistruhen si pasuri në përdorim dhe të llogaritet zhvlerësimi i tyre. Tutje, të siguroj se regjistri i pasurive është i plotë, pasuritë janë regjistruar drejtë dhe reflektojnë vlerën e saktë të tyre në regjistra. Po ashtu, të sigurojë se të gjitha shpenzimet të cilat nuk i plotësojnë kriteret e shpenzimeve kapitale e të cilat janë regjistruar si pasuri kapitale duhet të fshihen nga regjistri i pasurive. Me fokus të shtuar, duhet të trajtohen të gjitha pagesat regjistruara në regjistrin e pasurive që ndërlidhen me procesin e shpronësimeve të realizuara ndër vite bazuar në vendimet gjyqësore/përmbartimore.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B2 - Shpalesje jo e saktë e detyrimeve kontigjente në PFV**

#### **Gjetja**

Sipas nenit 18 të Rregullores nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, “Organizatata buxhetore në harmoni me LMFPP-në raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente”.

Detyrimet kontigjente të shpalesura nga ministria kryesisht kanë të bëjnë me konteste gjyqësore për shpronësime. Prandaj, për prezantimin e vlerës së tyre në PFV, ministria për vitin 2023 ka përdorur metodën e supozuar duke llogaritur rreth 50% të vlerës së vlerësuar sipas vendimit përfundimtar të Qeverisë për shpronësimet. Ne identifikuam se detyrimet kontigjente të prezantuara në PFV ishin nënvlerësuar për 16,534,867€ si rezultat i mangësive në vijim:

- Në 35 raste vlera e ankesave dhe pretendimeve gjyqësore ishte më e ulët se vlera e prezantuar në PFV duke mbivlerësuar detyrimet kontigjente për 2,841,038€; si dhe
- Në 13 raste vlera e ankesave dhe pretendimeve gjyqësore ishte më e lartë se vlera e prezantuar në PFV dhe kjo ka rezultuar me nënvlerësim të vlerës së detyrimeve kontigjente për 19,375,905€.

Në anën tjetër, në katër (4) raste në vlerë 1,225,777€, nuk kemi arritur të

vlerësojmë vlerën e prezantuar në PFV, pasi që dëshmitë ishin të pakompletuara.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së zyrtarëve të cilët mbajnë evidencat lidhur me detyrimet kontingjente si dhe mangësive në funksionimin e kontrolleve të brendshme gjatë procedimit të lëndëve për raportimin e detyrimeve kontingjente në PFV.

- Ndikimi** Prezantimi i detyrimeve kontingjente në vlera jo të sakta ndikon që palët e interesit apo shfrytëzuesit e PFV të mos informohen drejtë dhe saktë lidhur me shpalosjen e këtyre detyrimeve, njëherit ndikon në planifikim jo të mirë të buxhetit për vitin vijues.
- Rekomandimi B2** Ministri duhet të siguroj që detyrimet kontingjente prezantohen në shuma të sakta dhe se mbahen evidenca të plota me dëshmi mbështetëse lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B3 - Klasifikim jo adekuat i shpenzimeve

- Gjetja** Sipas nenit 18 pikës 3 të rregullës financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël, po ashtu me planin kontabël të Thesarit janë përcaktuar kodet dhe kategoritë përkatëse të shpenzimeve që OB duhet të aplikojnë.
- Kemi identifikuar se, ministria ka paguar nga kategoria e investimeve kapitale shpenzime të cilat nuk i plotësonin kriteret e shpenzimeve kapitale dhe i takojnë natyrës së mallrave dhe shërbimeve, si rrjedhojë kategoria e investimeve kapitale ishte mbivlerësuar për 6,249,500€. Përkatësisht, kjo kishte ndodhur për shkak të realizimit të pagesave që kishin të bënin me shpenzimet për interesin e aplikuar për vonesat në kryerjen e kompensimeve të vlerës së tokës së shpronësuar bazuar në vendimet gjyqësore/përmbarimore, si dhe pagesave që kishin të bënin me kompensimin e dëmit dhe fitimin e humbur të shkaktuar nga procesi i shpronësimeve.
- Tutje, për shkak të pagesave të ekzekutuara nga Thesari sipas vendimeve gjyqësore, shpenzimet janë keq klasifikuar në vlerë prej 1,561,103€. Përkatësisht:
- Nga kategoria e investimeve kapitale ishin paguar 1,051,065€ për mallra dhe shërbime. Ngase, pagesat kishin të bëjnë me kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga ministria ndaj operatorit ekonomik si dhe me pagesën e shpenzimeve të kamatës dhe shpenzimeve tjera procedurale, dhe
  - Nga kategoria e mallra dhe shërbimeve ishin paguar 510,038€ për investime kapitale, si rezultat i ekzekutimit të pagesave për shpronësimet.
- Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve ishte rezultat i mos funksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme.

- Ndikimi** Pagesat e kryera nga kategoritë jo adekuate ekonomike ndikojnë në

prezantim jo të drejtë të shpenzimeve duke ofruar informata jo të sakta për lexuesit e PFV. Po ashtu, duke mbivlerësuar/nënvlerësuar kategoritë ekonomike për vlerën e këtyre shpenzimeve.

**Rekomandimi B3** Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet ekonomike përkatëse, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

**Çështja B4 - Mungesa e evidencave për vijueshmëri në punë**

**Gjetja** Neni 9, paragrafi 2 dhe 3 i Rregullores (QRK) Nr.07/2022 Për orarin e punës dhe pushimet e zyrtarëve publik përcakton se: "Çdo zyrtar publik është i obliguar që të shënohet në librin e vijueshmërisë në punë ose në regjistrin elektronik, varësisht se cilën ka në përdorim institucioni dhe mos regjistrimi në librat e vijueshmërisë në punë apo në regjistrin elektronik, llogaritet si mos prezencë në punë.

MMPHI ende nuk ka të rregulluar çështjen e stafit (62 punonjës të komunitetit serb) të cilët paguhen por nuk kanë vijueshmëri në punë. Ndonëse kjo situatë po përsëritet, ministria ende nuk ka arritur të ndërmerr masa konkrete në sistemimin, angazhimin dhe monitorimin e kësaj kategorie të të punësuarve. Buxheti i shpenzuar për pagat e tyre për vitin 2023 ishte 398,164€.

Për ministrinë kjo çështje është mjaft sfiduese për sistemimin e tyre në hapësira të përcaktuara të punës, për faktin që edhe nuk kanë objektiva të përcaktuara të punës, prandaj edhe nuk zhvillojnë asnjë aktivitet në ministri.

**Ndikimi** Pagesat e punonjësve në mungesë të dëshmive për vijueshmëri në punë dhe në mungesë të angazhimit për kryerjen e detyrave zyrtare, konsiderohen si pagesa të pa arsyeuara dhe dëmtojnë buxhetin e ministrisë.

**Rekomandimi B4** Ministri duhet të analizoj situatën e krijuar duke siguruar se janë vlerësuar të gjitha mundësitë për gjetjen e një zgjidhje, dhe të ndermerren veprime të cilat janë në përputhje me kërkesat ligjore.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja B5 - Tejkallim i pagesave për pozicione për kontratat me çmim për njësi

**Gjetja** Neni 54.15 i Rregullores Nr. 001/2022 për prokurim publik, përcakton se kurdo që Autoriteti kontraktues nuk dinë sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" ose secilit "artikull" në mënyrë që Autoriteti Kontraktues të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët, në këto raste nuk vlen pragu apo tavan plus/minus tridhjetë përqind (30%).

Në 10 raste kemi identifikuar se ministria ka përdorur kontratat publike kornizë me çmim për njësi duke specifikuar edhe sasi të indikative/vlerën e parashikuar për një vit dhe përkundër rregullave ka aplikuar pragun apo tavanin plus/minus tridhjetë përqind (30%) në pozicione. Kjo ka rezultuar me tejkallim të vlerës së këtyre pozicioneve nga katër (4) pozicione deri në 39 pozicione në vlerë të përbashkët 1,192,115€.° Prej tyre në shtatë (7) raste ishte tejkalluar edhe vlera e parashikuar e kontratave për një vit.

Kjo ka ndodhur si pasojë e mos funksionimit të duhur të kontroleve nga menaxherët e kontratës lidhur me pajtueshmërinë ligjore gjatë realizimit të kontratave.

**Ndikimi** Mos respektimi i dispozitave ligjore sipas llojit të kontratave ndikon në tejkallim të shpenzimeve dhe njëkohësisht sjellë vështirësi në realizimin e projekteve tjera të ministrisë.

**Rekomandimi B5** Ministri duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës kontrole të duhura në respektimin e dispozitave ligjore, përkatësisht kushteve të pagesave të parapara sipas llojit të kontratave, në mënyrë që të mos krijohen shpenzime përtej planifikimit të tyre kontraktual.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### Çështja B6 - Ndryshime në sasi të paramasës pa aprovim paraprak

**Gjetja** Neni 61.22 dhe 61.23 të Rregullave dhe UOPP theksojnë se aty ku ndryshohet kontrata me qëllim të ndryshimit të termave dhe kushteve fillestare, ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit, si dhe ndryshimi i kontratës nuk do të lëshohet operatorit ekonomik para marrjes së aprovimit nga ZKA.

Kemi evidentuar tetë (8) kontrata në të cilat kishte pasur ndryshime të sasive të kontraktuara duke rritur/zvogëluar sasinë e realizuar por pa rritur çmimin total të kontratës. Ndryshimet ishin në katër (4) deri 86 pozicione apo në vlerë prej 5,881€ deri në 698,506€. Vlen të theksohet se, dy prej tyre, tejkallimet ishin për pozicionet të cilat ishin të aneks kontratës apo paramasës se ri-shikuar.

Për këto ndryshime nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme nga ZKA.

Këto mangësi kishin ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të projekteve dhe mos funksionimit të kontrolleve të duhura lidhur me mbikëqyrjen e këtyre projekteve.

#### Ndikimi

Ndryshimi i paramasës së projektuar dhe të kontraktuar në mungesë të aprovimeve të duhura rrezikon që realizimi i punëve të mos jetë në pajtim me kërkesat e projektit. Kjo mund të ndikojë në cilësinë e punëve të kryera dhe në përmbushjen e kontratës sipas objektivave të përcaktuara si dhe rrit mundësinë për manipulime me pozicionet dhe paramasën e tenderit fillestar.

#### Rekomandimi B6

Ministri përmes menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet se për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratave të kërkohen pëlqimet paraprake dhe aprovimet përkatëse në përputhje me rregullat e aplikueshme.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B7 - Ndryshim i kushteve kontraktuale duke mos zbatuar dispozitat ligjore

#### Gjetja

Neni 70.24 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik përcakton se funksionet e menaxherit të Projektit/kontratës janë: Të nxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës, si dhe 71.4 përcakton se ndryshimi i kontratës për sasi të shtesë të artikujve të njëjtë do të përdorë çmimet e njëjta apo më të ulëta për njësi si në kontratën fillestare. Për pozicionet të cilat nuk ka çmime në kontratën fillestare AK duhet të zbatohet nenin 35.3 të LPP-së<sup>7</sup>. Ndërsa sipas nenit 71.5, asnjë ndryshim në kontratë nuk do ta shtojë çmimin total të kontratës me më shumë se 10% të çmimit fillestar të kontratës.

Në dy raste kemi identifikuar se ministria ka vepruar në mos-përputhje me nenin 35.3 të LPP-së duke mos aplikuar procedurën e duhur për kryerjen e punës. Përkatësisht:

- Për kontratën publike për “Mirëmbajtjen verore dhe dimërore e autoudhës A7 (Ibrahim Rugova) Llot 2” me çmim për njësi 123,262€, ministria me operatorin e njëjtë ka aprovuar një urdhër-variacion duke ndryshuar termat dhe kushtet e kontratës. Ky ndryshim ka të bëjë me shtimin e 16 pozicioneve të reja në vlerë 73,768€ (pa e tejkualuar 10% të vlerës së kontratës bazë), për të cilat nuk ka pasur çmime të përcaktuara në kontratën fillestare.
- Për kontratën “Mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për vitet 2022-2023, 2023-2024 dhe 2024-2025, Regjioni Mitrovica - Lot 2” me çmim për njësi 6,814€, apo 388,400€ për një vit, ministria kishte rritur sasinë e kontraktuar në një pozicion nga 1m<sup>2</sup> në 94,215m<sup>2</sup> (që kishte të bënte me prerjen e barit, shkurreve dhe vegjetacionit). Ky ndryshim ishte bërë duke u bazuar në raportin e një komisioni të themeluar nga Sekretari i Përgjithshëm për shqyrtimin e kërkesës së menaxherit të kontratës për rritje të sasisë së këtij pozicioni. Si rezultat i kësaj, vlera e ndryshimit të kontratës ishte 24% e çmimit fillestar të kontratës.

Mos aplikimi i procedurave të duhura të prokurimit me rastin e ndryshimit të kushteve kontraktuale ka ndodhur si rezultat i anashkalimit të kontrolleve. Në rastin e shtimit të pozicioneve të reja duke e përdorur si arsye kryerjen e

kësaj pune me emergjencë. Ndërsa, në rastin e rritjes së sasive ministria e vlerëson se ishte bërë një lëshim teknik gjatë hartimit të paramanës dhe se kishte konsideruar si të mjaftueshme vetëm raportin e komisionit duke mos aplikuar kërkesat e rregullores së prokurimit.

- Ndikimi** Realizimi punëve pa procedurën e duhur të ndryshimit të kontratës mund të shkaktojë shpenzime më të larta se çmimi përkatës i tregut dhe kualitet jo të mirë të punës. Ndërsa ndryshimi i paramasës së projektuar dhe të kontraktuar jep mundësinë për manipulime me pozicionet dhe paramasat e tenderit fillestar.
- Rekomandimi B7** Ministri duhet të siguroj që aplikohen masat e duhura të kontrollit të cilat janpin siguri se zbatohen kërkesat e nenit 35.3 te LPP-së, dhe të sigurojë që zhvillohen procedurat e duhura të prokurimit.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja A1 - Mangësi në procedurat e prokurimit

- Gjetja** Neni 59.3 i LPP përcakton se Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Për aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve të ndryshme të rrugëve dhe strukturave për vitet 2022-2024” në dosjen e tenderit tek “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” pika 4, është kërkuar që për Lot 2, Një Inxhinier i Diplomuar i Komunikacionit me pesë (5) vite përvojë pune profesionale (pas diplomimit) në lëmine e kërkuar. Ndërsa tek Lista e mjeteve, stabilimenteve, pajisjeve teknike dhe softwerëve të domosdoshme pika 6, një set të Stacionit total, me saktësi matëse (1÷3)” (të jetë i kalibruar brenda një vitit, të dëshmohet me certifikatë të kalibrimit nga kompania e licencuar).

Ministria kishte shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik përkundër që i mungonin dëshmitë të cilat vërtetojnë përvojën e punës pesë (5) vite të inxhinierit të komunikacionit (tek dëshmitë e ofruara ekzistojnë tri referenca por vetëm tek njëra prej tyre dëshmohet periudha një vjeçare e punës, ndërsa tek dy të tjerat mungon periudha kohore). Po ashtu, mungon edhe certifikata e kalibrimit nga kompania e licencuar për pajisjet e kërkuara.

Tutje, neni 41.6 i Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik përcakton se në rast se një tender (apo një pozicion i tenderit ku aplikohet çmimi i peshuar për njësi) duket të jetë jo normalisht i ulët, Autoriteti Kontraktues duhet të kërkoj me shkrim nga operatori ekonomik i cili ka dorëzuar tenderin ose pozicionin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ulët sipas paragrafit 41.3 ose 41.4 të kësaj rregullore, një deklaratë me shkrim e cila përfshinë një zbërthim të detajuar të pjesëve relevant të tenderit dhe e cila përfshinë një shpjegim për çmimin e ulët duke përdorur formularin standard të miratuar nga KRPP-ja "Shkresa standarde për tenderët jo-normalisht të ulët". Ndërsa sipas nenit 41.7, Operatori Ekonomik do t'i përgjigjet me shkrim Autoritetet Kontraktues. Nëse jo, tenderi do të refuzohet.

Për aktivitetin e prokurimit “Hartimi i projekteve të ndryshme të rrugëve dhe strukturave për vitet 2022-2024” Loti I - Zgjerimet e rrugëve ekzistuese dhe

rrugët e reja me 4 korsi, çmim i peshuar për njësi me vlerë të parashikuar 110,000€, kemi evidentuar se në gjashtë (6) pozicione (si p.sh. punimi i projektit të largimit të ujërave të zeza, punimi i projektit të ujësjellësit dhe dislokimit të instalimeve, punimi i projektit të elektrikes etj), OE kishte ofruar me çmime shumë të ulëta dhe se tenderi i dorëzuar i plotëson të gjitha kërkesat e nenit 41.3 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik për tu konsideruar tender jo-normalisht i ultë. Megjithatë, ministria nuk kishte kërkuar një deklaratë me shkrim nga OE për të shpjeguar çmimin e ofruar.

Kjo ka ndodhur si rezultat i pakujdesisë së komisionit gjatë vlerësimit të ofertave.

**Ndikimi**

Mos plotësimi i kriterëve të kërkuara dhe mungesa e deklaratës në rastin e tenderit që duket të jetë jo-normalisht i ultë, mund të ketë ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës, rrjedhimisht mund të ndikoj në mos realizimin e të gjitha pozicioneve e në veçanti të atyre me çmime të ulëta.

**Rekomandimi A1**

Ministri duhet të sigurojë se Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit ka një mbikëqyrje ndaj komisioneve të vlerësimit, në mënyrë që, në rastet kur oferta përmban çmime jo normalisht të ulëta, të sigurohet se përfituesi i kontratës do të qëndroj prapa ofertës së tij. Kjo duhet të bëhet përmes veprimeve të konfirmuara siç i parashohin rregullat e prokurimit, dhe se vendimi për dhënie të kontratës bëhet vetëm pas marrjes së sigurisë se të gjitha kërkesat janë përmbushur.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 213,212,622€, prej tyre ishin shpenzuar 133,316,067€ apo 63%. Këto shpenzime kryesisht kanë të bëjnë me ndërtime dhe shtresëzime të rrugëve, pagesa për shpronësime të tokave, bashkëfinancime të projekteve bazuar në Memorandumet me komunitet, rregullime të lumenjve etj.

#### Çështja B8 - Vonesa në realizimin e projekteve

**Gjetja** Në kontratat e nënshkruara ndërmjet ministrisë dhe operatorëve ekonomik përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve.

Në pesë (5) raste, kemi vërejtur që punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik siç parashihej me kontratë. Rastet e identifikuar janë:

- Kontrata “Ndërtimi i Tranzitit në Malishevë “ loti 1, në vlerë 959,026€ ishte nënshkruar me datë 14.06.2019. Sipas kontratës data e fillimit të punëve ishte 04.07.2019, dhe përfundimi për 180 ditë pune. Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2023, përkatësisht për më shumë se tre vite ishte 142,496€, apo 15% e vlerës së kontraktuar.
- Kontrata “Rehabilitimi i rrugës Rajonale R-108, Segmenti II” në vlerë 3,789,533€ ishte nënshkruar me datën 09.07.2019. Sipas kontratës data e fillimit të punëve ishte 28.07.2019, dhe përfundimi për 705 ditë pune ose rreth 25 muaj (aneks kontrata me datën 23.09.2021 në vlerë 378,593€ me afat për 120 ditë pune). Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2023, përkatësisht për më shumë se tre vite ishte 2,771,478€ apo 66% e vlerës së kontraktuar.
- Kontrata “Ndërtimi i Autoudhës A7.1- Dheu i Bardhë-Udhëkryqi Bresic Loti 1” në vlerë 18,468,427€ ishte nënshkruar me datën 13.02.2018. Sipas nenit 7 të kontratës, afati kohor i përfundimit të punimeve është 30 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Lidhur me këtë projekt ishte nënshkruar edhe një aneks kontratë me datën 14.06.2019 në vlerë 1,843,392€ me afat 60 ditë për realizim të punëve. Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2023 ishte 16,246,643€ apo 80%.
- Kontrata “Asfaltimi i Rrugës lokale nga kryqëzimi N25 - Grejkoc - Rrafshi Livadheve” kontrata në vlerë 2,980,445€ ishte nënshkruar me datën 06.05.2020 (aneks kontrata me vlerë 297,248€ me datën 03.12.2021), dhe realizimi i punëve ishte për 15 muaj. Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2023 ishte 1,403,681€ apo 43% e vlerës së kontraktuar.
- Kontrata “Zgjerimi i rrugë Nationale N9.1, segmenti Dollc-Gjakovë - Loti 1” në vlerë 4,616,601€ ishte nënshkruar me datën 11.03.2019. Sipas kushteve të veçanta të kontratës, afati kohor i përfundimit të punimeve është 200 ditë. Lidhur me këtë projekt ishte nënshkruar edhe një aneks kontratë me datën 17.09.2019 në vlerë 460,273€ me afat 35 ditë për realizim të punëve. Vlera e punëve të realizuara deri në fund të vitit 2023 ishte 3,209,233€ apo 60%.

Kjo gjendje ishte ndikuar nga mungesa e një analize të mirëfilltë para

inicimit të projekteve kapitale që kishin të bënin lidhur me problemet e shpronësimit të tokave, gabimeve në hartimin e projekteve ekzekutive, ku gjatë realizimit të punëve ka rezultuar se nuk përshtaten me gjendjen e terrenit etj.

**Ndikimi** Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që ministria të mos arrijë objektivat e përcaktuara, vështirësi në qarkullimin e qytetarëve në rrugët e caktuara dhe njëherësh mund të shkaktojnë vështirësi buxhetore për vitet pasuese.

**Rekomandimi B8** Ministri duhet të siguroj se para inicimit të projekteve paraprakisht kryhet procesi i shpronësimit të tokave në të cilat parashihet realizimi i projekteve si dhe ti kushtohet rëndësi përpilimit/përgatitjes të projekteve ekzekutive në mënyrë që realizimi i punimeve të bëhet sipas planeve dinamike.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja B9 - Pagesat përmes vendimeve gjyqësore

**Gjetja** Neni 39.1 i LMFPP nr.03/L-048, obligon Ministrinë për pagesën e çdo fature të vlefshme brenda afatit 30 ditësh nga data e pranimit të faturës apo kërkesës për pagesë. Po ashtu, edhe neni 40.1 thekson “Kur një gjykatë nxjerrë urdhër ose vendim me të cilin kërkohet nga një autoritet publik që të paguajë çfarëdo lloji të kompensimit monetar ndaj një personi dhe urdhri ose vendimi nuk i nënshtrohet të drejtës së ankesës nga autoriteti publik ose autoriteti publik nuk e ka ushtruar këtë të drejtë me kohë, gjykata menjëherë i dërgon një kopje të urdhrit ose vendimit Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë përkatëse, për ekzekutimin e pagesës në fjalë”.

Pagesat e ekzekutuara përmes vendimeve gjyqësore në vitin 2023 ishin 4,476,111€ dhe në përgjithësi kanë të bëjnë me pagesën e shpronësimeve. Në katër (4) raste të testuara të këtyre pagesave në vlerë 1,654,803€, ministria përveç borxhit kryesor në vlerë 1,371,860€ kishte paguar shpenzime shtesë për kamatë dhe procedura gjyqësore në vlerë 282,942€.

Kjo dukuri ka ndodhur kryesisht si rezultat i ankesave të shumta ndër vite të palëve të pakënaqura me vlerësimin e pronave në vendimin përfundimtar të shpronësimit, vlerësim ky i kryer nga Departamenti i Tatimit në Pronë/Ministria e Financave.

**Ndikimi** Kjo situatë ka rezultuar me rritjen e kostos së ministrisë duke krijuar vështirësi në realizimin e projekteve të aprovuara për vitin përkatës/vijues.

**Rekomandimi B9** Ministri në bashkëpunim me akterët e përfshirë në procesin e shpronësimit, duhet të identifikojnë dobësitë në këtë proces dhe të ndërmarrin masa në evitimin e kontesteve të shumta gjyqësore në mënyrë që mos të dëmtohet buxheti i ministrisë me kosto shtesë.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja B10 - Mangësi në pagesat për shpronësime**

- Gjetja** Neni 16.2 i Ligjit nr. 03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme përcakton “Organi Shpronësues ia paguan, ose kërkon nga parashtuesi i kërkesës ose Përfituesi i pritur - nëse ka të këtillë - që t’ua paguajë shumën e kompensimit të përcaktuar në Vendimin Përfundimtar, Pronarit të prekur ose Zotëruesit të Interesit. Kompensimi i kërkuar në Vendimin Përfundimtar do të jetë: 2.1. shuma e përcaktuar në aktin përkatës të vlerësimit plus; 2.2. interesi në atë shumë i cili është akumuluar duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të Vendimin Përfundimtar deri në datën e pagesës. Ky interes akumulohet në shkallë prej shtatë përqind (7%) interes i thjeshtë vjetor dhe kapitalizohet në bazë vjetore.
- Në tre (3) raste të testuara në vlerë 3,159,932€, kishte vonesa në pagesën e shpronësimeve prej 9 muaj deri në 6 vite pas datës së vendimit përfundimtar. Duhet theksuar se, përveç rasteve të bazuara në vendimet gjyqësore/përmbartimore apo pajtimeve gjyqësore, ministria nuk kishte paguar në asnjë rast interesin ligjor për vonesat në kompensimin e pronarëve të tokave të shpronësuara. Vlera totale e pagesave të bëra gjatë vitit 2023 që nuk janë bërë sipas vendimeve gjyqësore/përmbartimore është prej 9,041,973€ (përfshirë këtu pagesat e realizuara në llogarinë e mirëbesimit në BQK).
- Ministria nuk ka ndërmarrë veprime edhe pse kjo çështje është ngritur edhe në vitet paraprake.
- Ndikimi** Mos-aplikimi i interesit në pagesat e shpronësimit është në kundërshtim me ligjin dhe dëmton përfituesit, respektivisht pronarët e tokave të shpronësuara.
- Rekomandimi B10** Ministri duhet të siguroj buxhet të mjaftueshëm për kryerjen e obligimeve financiare të shpronësimeve si dhe të siguroj që kompensimi të bëhet në harmoni me legjislacionin e zbatueshëm. Më tutje, ministri të formojë një komision i cili do të analizojë bazën ligjore sa i përket pagesave dhe interesit të thjeshtë vjetor në lidhje me shpronësimet.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 1,977,579,295€, e pasurive jokapitale është 154,256€ si dhe e stoqeve 41,982€.

### Çështja A2 - Mbajtje e pasurive në klasën jo të duhur në regjistrin e pasurisë

- Gjetja** Neni 5 i rregullores Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare ka përcaktuar klasifikimin e përgjithshëm të pasurive. Ndërsa neni 6.1 përcakton se “Çdo organizatë buxhetore duhet të krijojë dhe azhurnoj regjistrin e pasurive jo financiare që i ka në menaxhimin e saj. Regjistri duhet të mbahet ndaras për çdo pasuri dhe në formë të agreguar sipas kategorive të klasifikuara në bazë të planit kontabël”.
- Kemi evidentuar se pagesat në vlerë prej 361,558,271€ (prej të cilave vetëm në vitin 2023 janë paguar 43,661,587€) për shpronësimin e tokave nga ministria, ndër vite janë regjistruar si ‘investim në vijim’ në regjistrin e pasurive kapitale. Të njëjtat sipas planit kontabël nuk do duhej të regjistrohen si investime në vijim. Si rezultat, nuk ka regjistrim të pasurisë në klasën e pasurive ‘Toka’.
- Ministria, regjistrimin e pagesave për shpronësimin e tokave si investim në vijim, e arsyeton si pasoj e vonesave në procesin e bartjes së pronësisë të ministria për tokat e shpronësuara, si dhe për shkak të ndërlidhjes së shpronësimeve me projektet kapitale për të cilat bëhej shpronësimi i tokave. Pavarësisht kësaj, për faktin që toka nuk duhet të regjistrohet fare si investim në vijim, duket se ka mungesë të konsultimit të rregullores për pasuritë dhe planit kontabël rreth klasës së pasurive.
- Ndikimi** Mos regjistrimi i pasurive në klasën e duhur ka ndikuar në pasqyrimin jo të drejtë të pasurive sipas klasave, rrjedhimisht nënvlerësimin e klasës ‘Toka’.
- Rekomandimi A2** Ministri duhet të siguroj se të gjitha tokat e shpronësuara për të cilat ka përfunduar kompensimi i pronarëve dhe janë plotësuar kushtet e regjistrimit, të regjistrohen në klasën e pasurive ‘Toka’, ashtu siç parashihet me planin kontabël.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

#### Çështja A3 - Mangësi në procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive jo financiare

- Gjetja** Neni 19.4.3 i Rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare përcakton se çdo fund vit duhet të bëhet krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen e regjistrave të pasurive jo financiare. Ndërsa neni 21 i po kësaj rregulloreje ka përcaktuar kërkesat për vlerësimin e pasurive jo financiare.
- Procesi i inventarizimit të pasurive jo financiare ishte kryer pas datës së raportimit të PFV. Rrjedhimisht, nuk dihet diferenca mes gjendjes së kontabilitetit dhe inventarizimit. Raportimi i pasurive në PFV ishte bërë sipas regjistrit kontabël. Po ashtu, nuk ishte bërë fare vlerësimi i pasurive jo financiare sipas kërkesave të rregullores.
- Kjo gjendje ishte kryesisht për shkak të mungesës së njohurive nga ana e komisionit lidhur me kërkesat e rregullores për menaxhimin e pasurive, si

dhe mungesës së udhëzuesve të brendshëm lidhur me procesin e inventarizimit dhe vlerësimit të pasurive.

**Ndikimi**

Mos krahasimi i rezultateve të inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive dhe mos vlerësimi i pasurive, pamundëson marrjen e sigurisë lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

**Rekomandimi A3**

Ministri duhet të siguroj se komisioni për inventarizimin e pasurive ka përgatitjen dhe njohuritë e duhura lidhur me pasuritë dhe procesin e inventarizimit, si dhe pas këtij procesi të gjitha ndryshimet të reflektohen në regjistrin e pasurive. Po ashtu, të krijoj komisionin i cili do kryej vlerësimin e pasurive sipas kërkesave të udhëzuesit për menaxhimin e pasurive jo financiare.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.3 Të arkëtueshmet

MMPHI në PFV e vitit 2023 ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 4,640,514€. Këto kanë të bëjnë me obligime të pa-arkëtuara të kompanive shfrytëzuese të ujit, faturime për pompa të karburanteve, hyrje-daljet e objekteve afariste etj.

#### Çështja B11 - Mos ndërmarrja e veprimeve për inkasim të borxheve

**Gjetja** Neni 4 i Udhëzimit Administrativ 1/2014 mbi Caktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e tokës së rrugëve nacionale dhe rajonale përcakton se "Tarifat për shfrytëzimin e tokës për vendosjen e instalimeve dhe kyçjeve në rrugët nacionale dhe rajonale, shfrytëzimin e tokës e cila jepet me qira dhe vendosje të objekteve të përkohshme, bëhet sipas tarifave të përcaktuara". Më tutje neni 6 - Dispozitat kalimtare parasheh që me hyrjen në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ Ministria do të modifikoj të gjitha kontratat për shfrytëzimin e tokës të cilat i takojnë rrugëve Nacionale dhe Rajonale brenda afatit prej gjashtë (6) muaj. Po ashtu, sipas marrëveshjeve të nënshkruara me shfrytëzuesit e pronave publike përcaktohen afatet e inkasimit të të arkëtueshmeve.

Në tri (3) raste të testimit të llogarive të arkëtueshme në vlerë të përbashkët prej 222,407€, ne kemi identifikuar që Ministria kishte faturuar kontraktuesit ndër vite por nuk kishte arkëtuar asnjë borxh. Kontratat për shfrytëzimin e brezit rrugor në tri raste ishin lidhur në vitin 1999 dhe 2000, ndërsa operatorët e kontraktuar nuk kishin kryer pagesa që nga kontraktimi.

Për më tepër, me hyrjen në fuqi të UA 1/2014 në vitin 2014, Ministria kishte faturuar kontraktuesit me tarifën e reja por nuk kishte ndërmarrë masa për t'i modifikuar kontratat e tyre sipas afatit ligjor të përcaktuar në udhëzuesin e ri administrativ.

Lidhur me këtë çështje është rekomanduar edhe në vitet paraprake të auditimit. Sipas dokumenteve të ofruara, ministria kishte tentuar në disa raste t'i arkëtoj borxhet përmes procedurave përmbare dhe gjykatës por si rezultat i kontratave dhe borxheve të vjetërsuara, faturave të pa-nënshkruara nga pranuesit, nuk është arritur të arkëtohet borxhi.

**Ndikimi** Mos ndërmarrja e masave konkrete për arkëtimin e borxheve, mund të ndikojë në mos përmbushjen e planit të buxhetit për shkak të mos realizimit të të hyrave.

**Rekomandimi B11** Ministri duhet të sigurojë ripërtëritjen e kontratave me shfrytëzuesit e pronave publike në përputhje me legjislacionin përkatës si dhe të krijojë mekanizma efektiv për arkëtimin e borxheve.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 2.3.4 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Funksioni i auditimit të brendshëm është i themeluar me Statutin e Njesisë së Auditimit (NjAB). Kjo njësi operon me 5 auditor (drejtori dhe 4 auditor). NjAB kishte përgatitur planin vjetor të auditimit. Nga shtatë (7) auditime të planifikuara ka realizuar pesë (5) auditime, si dhe gjashtë (6) auditime me kërkesë nga menaxhmenti. Këto raporte kanë rezultuar me 74 rekomandime, prej të cilave, rekomandime të zbatuara ishin 47, në proces 22 dhe të pa zbatuara pesë (5).

#### Çështja B12 - Komiteti i auditimit jo funksional

##### Gjetja

Neni 4.1 i UA MF-NR. 01/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Komitetit të Auditimit në Subjektin e Sektorit Publik përcakton se çdo subjekt i sektorit publik që ka të themeluar Njësine e auditimit të brendshëm në nivel të organit kryesor sipas legjislacionit në fuqi, themelon Komitetin e Auditimit.

Ministria në tetor të vitit 2022 ka shfuqizuar vendimin për themelimin e Komitetit të Auditimit, pasi nuk kishte mbajtur asnjë takim dhe nuk ishte funksional siç kërkohet me udhëzimin relevant. Edhe gjatë vitit 2023, nuk janë ndërmarrë veprime lidhur me themelimin e komitetit të auditimit.

Kjo situatë është rezultat i mungesës së veprimeve të ndërmarra nga ministria për themelimin të komitetit të ri ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore.

##### Ndikimi

Një situatë e tillë zbeh ndikimin e proceseve të kontrollit të brendshëm që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe vlerësimin e rrezikut, si dhe pamundëson mbikëqyrjen e punës së auditimit të brendshëm dhe marrëdhënies së tij me menaxhmentin në drejtim të përmirësimit të kontrollit të brendshëm.

##### Rekomandimi B12

MMinistri duhet të siguroj që në afat sa më të shpejtë kohor të funksionalizohet Komiteti i Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja ndaj NjAB-së duke siguruar pavarësinë e kësaj njësie.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>8</sup>	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>251,684,838</b>	<b>249,580,044</b>	<b>158,165,293</b>	<b>127,999,741</b>	<b>143,815,760</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	187,622,875	185,500,841	144,758,446	113,850,439	137,304,739
Financimi përmes huamarrjes	25,861,963	25,861,963	804,621	1,801,248	3,107,767
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	38,200,000	38,200,000	12,592,573	12,077,653	3,401,670
Donacionet vendore	0	3	0	0	0
Donacionet e jashtme	0	17,238	9,653	270,401	1,583

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 2,104,793€. Ky ndryshim ka ardhur si rezultat i ndarjeve të reja dhe shkurtimeve buxhetore me vendime qeveritare.

Në vitin 2023 MMPHI kishte shpenzuar 158,165,293€ apo 63% të buxhetit final, pra me një rritje prej 5% në raport me vitin paraprak. Në këtë përqindje relativisht të ulët të realizimit ka ndikuar në masë më të madhe mos-shpenzimi i fondeve të ndara nga Huamarrja dhe Klauzola e Investimeve. Në vitin 2023 nga 25,861,962€ mjete të planifikuara nga Huamarrja ishin shpenzuar vetëm 804,621€ apo rreth 3%, ndërsa nga 38,200,000€ të planifikuara nga Klauzola e Investimeve ishin realizuar vetëm 12,592,573€ apo 33%. Pra, zbatimi i buxhetit në përgjithësi mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe shpenzimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>251,684,838</b>	<b>249,580,044</b>	<b>158,165,293</b>	<b>127,999,741</b>	<b>143,815,760</b>
Pagat dhe mëditjet	4,083,931	4,425,818	4,418,972	3,618,297	3,685,246
Mallrat dhe shërbimet	29,415,559	29,813,300	19,063,632	17,243,070	14,961,967
Komunalitë	481,490	484,490	244,868	250,641	219,050
Subvencionet dhe transferet	1,643,814	1,643,814	1,121,754	1,172,636	1,283,507
Investimet Kapitale	216,060,044	213,212,622	133,316,067	105,715,097	123,665,991

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë ekonomike të buxhetit janë dhënë më poshtë:


Buxheti final për paga dhe mëditje në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 341,888€. Kjo rritje ishte rezultat i zbatimit të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik si dhe ndarjeve nga fondet e përcaktuara të donatorëve në programin e “Agjencisë kosovare për mbrojtjen e mjedisit” (AKMM). Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 100%.

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet komunale) në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 400,741€. Ky ndryshim ishte rezultat i vendimeve të Qeverisë për ndarje dhe vendimeve për kursime. Realizimi i buxhetit final ishte 64%.

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 1,643,814 dhe nuk kishte pësuar ndryshime në raport me buxhetin fillestar. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 68%.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 2,847,422€. Ky ndryshim ishte rezultat i vendimeve Qeveritare për kursime në vlerë 35,260,733€. Po ashtu, kishte ndarje të reja në këtë kategori me vendime Qeveritare në vlerë 32,413,311€. Shkalla e realizimit të buxhetit ishte 63%. Sa i përket realizimit jo të kënaqshëm të shpenzimit të buxhetit në këtë kategori kanë ndikuar disa faktorë, si tejzgjatja e procedurave të prokurimit për projekte të reja si rezultat i ankesave të shumta të operatorëve në OSHP. Ndërsa, për projektet e financuara nga burimet e Huamarrjes dhe Klauzolës së investimeve procedurat e prokurimit ishin realizuar në vitin 2023 dhe kontratat janë lidhur në vitin 2024. Po ashtu, buxheti për investime kapitale kryesisht ka qenë i orientuar në projektet në vazhdim të cilat kanë qenë të kontraktuara para vitit 2023.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e realizuara nga MMPHI në vitin 2023 ishin në vlerë 5,071,471€. Të hyrat jo tatimore kryesisht kanë të bëjnë me të hyra të realizuara nga taksat e lejeve të vozitjes, licencat për transport të mallrave, të hyrat nga shfrytëzimi i ujit, licencat për shfrytëzimin e pyjeve, licenca tjera për afarizëm etj, ndërsa të hyrat tjera kanë të bëjnë me të hyrat nga kthimi i mjeteve nga viti i kaluar.

**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>5,589,171</b>	<b>5,589,171</b>	<b>5,071,471</b>	<b>4,691,164</b>	<b>6,107,582</b>
Të hyrat jo tatimore	5,589,171	5,589,171	5,001,101	4,658,223	5,929,546
Të hyrat tjera	0	0	70,370	32,942	178,036


## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV të vitit 2022 ka rezultuar me 20 rekomandime kryesore. Ministria kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2023, pesë (5) rekomandime ishin zbatuar, tre (3) rekomandime nuk ishin të aplikueshme më, si dhe 12 rekomandime të tjera nuk ishin zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4 (ose Tabelën e rekomandimeve).

### Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak



### Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Ministri duhet të forcoj mekanizmat e kontrollit të brendshëm në fushën e pasurisë për të siguruar prezantim të plotë dhe të drejtë të gjendjes së pasurisë së institucionit në pajtim me kërkesat ligjore.	Edhe këtë vit janë identifikuar disa pasuri të paregjistruara si dhe regjistrime të gabuara të pasurive jo kapitale në SIMFK. Kjo është trajtuar te çështja B1.	Nuk është i aplikueshëm më
2.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që detyrimet kontingjente prezantohen në shuma të sakta dhe se mbahen evidenca të plota me dëshmi mbështetëse lidhur me çështjet që janë në procedurë gjyqësore.	Edhe këtë vit shpалosja e detyrimeve kontingjente nuk ishte e saktë.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për opinion	Ministri duhet të sigurojë se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që pagesat dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhen në kodet ekonomike përkatëse, për të mundësuar raportim të drejtë të tyre në PFV në përputhje me planin kontabël. Nëse planifikimet buxhetore nuk përkojnë me natyrën e shpenzimit dhe nevojat e ministrisë, duhet të bëhet riridestini i mjeteve me qëllim të sigurimit të fondeve për pagesën e rregullt të shpenzimeve.	Edhe këtë vit kemi identifikuar keq klasifikim të shpenzimeve në kategorinë Mallra dhe shërbime dhe Investime kapitale.	Nuk ka filluar zbatim
4.	Baza për opinion	Ministri duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për angazhimin e këtyre të punësuarve duke siguruar kushte pune, duke përcaktuar objektiva të qarta të punës si dhe të siguroj monitorim të vazhdueshëm siç parashihet me aktet ligjore.	Gjendja në raport me vitin paraprak lidhur me këtë kategori të të punësuarve ishte e njejtë.	Nuk ka filluar zbatim
5.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj se kontrollet në zyrën e financave janë plotësisht efektive në mënyrë që të bëhet raportimi i drejtë dhe i saktë i obligimeve të pa-paguara.	Nuk kemi evidentuar raste të tilla në këtë vit.	I zbatuar
6.	Baza për opinion	Ministri duhet të siguroj që departamentet përkatëse të bashkëpunojnë me zyrtarin e pasurive për të identifikuar të gjitha projektet e përfunduara, në mënyrë që pasuritë të regjistrohen si pasuri në përdorim dhe të llogaritet zhvlerësimi i tyre. Po ashtu, projektet e financuara dhe të përfunduara për komuna, të barten tek komunat përfituese duke i larguar nga regjistrat e ministrisë.	Mangësi të njejtja janë identifikuar edhe këtë vit.	Nuk ka filluar zbatim
7.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të sigurojë përmes zyrtarëve përgjegjës kontrolle të duhura në respektimin e dispozitave ligjore, përkatësisht kushteve të pagesave të parapara sipas llojit të kontratave, në mënyrë që të mos krijohen shpenzime përtej planifikimit të tyre kontraktual.	Edhe këtë vit kishte tejkalim të vlerave të kontratave.	Nuk ka filluar zbatim
8.	Baza për konkluzion	Ministri përmes menaxherëve të kontratave duhet të sigurohet se për çdo devijim nga termat dhe kushtet e kontratave të kërkohen pëlqimet paraprake dhe aprovimet përkatëse në përputhje me rregullat e aplikueshme.	Edhe në këtë vit kemi hasur në tejkalime të sasive të kontraktuara pa aprovimin paraprak nga ZKA.	Nuk ka filluar zbatim
9.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të siguroj që çdo shpenzim të jetë i mbështetur në kontratën përkatëse, po ashtu të sigurojë që zhvillohen procedurat e duhura të prokurimit.	Edhe këtë vit kemi identifikuar raste të ndryshimit të kushteve të kontratave duke mos zbatuar dispozitat ligjore.	Nuk ka filluar zbatim

10.	Baza për konkluzion	Ministri duhet të vendos kontrolle të shtuara financiare dhe të siguroj se zyrtarët financiar zbatojnë me përpikëri të gjitha procedurat e shpenzimeve, dhe të gjitha faturat të paguhen sipas rregullave të përcaktuara ligjore.	Çështjet e identifikuarat gjatë auditimit, kanë rezultuar me ndikim jo material dhe nuk kanë ndonjë efekt në këtë raport.	I zbatuar
11.	Pagat dhe mëditjet	Ministri duhet të siguroj se do të ndërmerren masa drejt hartimit dhe harmonizimit të të gjitha rregulloreve në përputhje me ndryshimet strukturore të ministrisë në mënyrë që të evitohen pozitat dhe shpenzimet e dyfishta.	Rregullorja për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës ishte aprovuar në prill të vitit 2024.	I zbatuar
12.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se janë identifikuar shkaqet e dëmit të ndodhur si dhe në përputhje me kushtet e parapara të kontratës, të zbatohen dispozitat lidhur me përgjegjësinë e defekteve. Po ashtu, të sigurohet se pranimi i punëve bëhet bazuar në cilësinë e materialeve dhe punës profesionale të OE, në të kundërtën të aplikohet sigurimi i ekzekutimit.	Nuk janë identifikuar raste të tilla këtë vit.	I zbatuar
13.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj se para inicimit të projekteve paraprakisht kryhet procesi i shpronësimit të tokave në të cilat parashihet realizimi i projekteve si dhe ti kushtohet rëndësi përpilimit/përgatitjes të projekteve ekzekutive në mënyrë që realizimi i punimeve të bëhet sipas planeve dinamike.	Edhe këtë vit kemi hasur vonesa në realizimin e projekteve kapitale. Nga shtatë projekte të theksuara në raportin paraprak, katër prej tyre vazhdojnë të jenë në vonesa si dhe një projekt është i raportit të vitit aktual.	Nuk ka filluar zbatimin
14.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj që para se të hartohen projektet ekzekutive, të jenë kryer të gjitha ekzaminimet në terren, përfshirë: matjet gjeodezike, incizimin e gjendjes reale në teren, zgjidhjen e çështjeve pronësore dhe përcaktimin e saktë të trashësisë së rrugëve. Në rastet e gabimeve me implikim financiar për MMPHI-në, jo vetëm të kërkohet korrigjimi i tyre por edhe të aplikohen penalizime tek kompania projektuese.	Eshte trajtuar në kuadër të çështjeve B6 dhe B8.	Nuk është i aplikueshëm më

15.	Investimet kapitale	Ministri në bashkëpunim me akterët e përfshirë në procesin e shpronësimit, duhet të identifikojnë dobësitë në këtë proces dhe të ndërmarrin masa në evitimin e kontesteve të shumta gjyqësore në mënyrë që mos të dëmtohet buxheti i ministrisë me kosto shtesë.	Edhe këtë vit janë identifikuar raste të njëjta.	Nuk ka filluar zbatimi
16.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj buxhet të mjaftueshëm për kryerjen e obligimeve financiare të shpronësimeve si dhe të siguroj që kompensimi të bëhet në harmoni me legjislacionin e zbatueshëm. Më tutje, ministri të formojë një komision i cili do të analizojë bazën ligjore sa i përket pagesave dhe interesit të thjeshtë vjetor në lidhje me shpronësimet.	Edhe këtë vit gjendja është e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimi
17.	Investimet kapitale	Ministri duhet të siguroj monitorim të vazhdueshëm të mekanizmave të krijuara për ecurinë e këtij procesi dhe në bashkëpunim me institucionet e përfshira të punojnë në drejtim të funksionalizimit të këtij sistemi dhe aplikimit të tij nga të gjitha institucionet.	Ministria ka ndërmarrë disa veprime gjatë vitit 2023. Mbetet që në bashkëpunim me MFPT, të shqyrtohen alternativat dhe mundësia që ky sistem të ndërlihet me sistemet tjera.	Nuk është i aplikueshëm më
18.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri të sigurojë se bëhet monitorimi i rregullt i shfrytëzimit të ujërave të Kosovës dhe në rastet kur shfrytëzuesit e ujërave operojnë pa leje ujore apo me leje të skaduar, të merren masa konkrete për ndalimin e veprimeve të jashtëligjshme sipas dispozitave të parapara me kornizën ligjore në fuqi.	Ministria kishte ndërmarrë masa duke nxjerr vendime për ndërprerje të aktivitetit për operatorët pa leje ujore si dhe duke shqiptuar masa me gjobë.	I zbatuar
19.	Llogaritë e arkëtueshme	Ministri duhet të sigurojë ripërtëritjen e kontratave me shfrytëzuesit e pronave publike në përputhje me legjislacionin përkatës si dhe të krijojë mekanizma efektiv për arkëtimin e borxheve.	Edhe gjatë vitit 2023, ministria nuk kishte bërë ripërtëritjen e kontratave dhe nuk kishte arritur të bëjë inkasimin e borxheve.	Nuk ka filluar zbatimi
20.	Auditimi i Brendshëm	Ministri duhet të siguroj që në afat sa më të shpejtë kohor të funksionalizohet Komiteti i Auditimit në përputhje me kërkesat ligjore, në mënyrë që të zbatohet mbikëqyrja dhe mbështetja ndaj NjAB-së duke siguruar pavarësinë e kësaj njësie.	Edhe këtë vit komiteti i auditimit nuk ishte funksional.	Nuk ka filluar zbatimi

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Zukë Zuka, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Mjellma Dibra, Drejtore e Auditimit



Ylber Sadiku, Udhëheqës i ekipit



Refiqe Morina, Anëtare e ekipit



Ganimete Dalloshi, Anëtare e ekipit



# Shtojca I: Letër konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
21.06.2024			
Numërtimi i Dokumentit	Titulli i Dokumentit	Klasifikimi i Dokumentit	
03	47	935 1	
Org. Jeshin.	Klasif. Kod	Proj. No.	No. Pajesje



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLICA OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
Numërtimi i Dokumentit	Titulli i Dokumentit	Klasifikimi i Dokumentit	
SP-02	3935/24	21.06.24	
Org. Jeshin.	Klasif. Kod	Proj. No.	No. Pajesje
01			
PRISHTINË / A			No. 1

**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
**Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës**  
**Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture**  
**Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure**

## LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Ministrisë së Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejshëm "Raport");
- Pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit;
- Brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Izëdin BYTYQJ

U.D. Sekretarit të përgjithshëm në MMPHI

Data: 21 Qershor 2024



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>9</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>10</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Projektet e pa regjistruara në SIMFK: 1. Ndertimi i 11 shtëpive në pjesën veriore të Kosovës”, 2. “Mirëmbajtja investive e rrugëve nacioanle dhe rajonale të Kosovës për vitin 2022 - Lot 1” 3. “Mirëmbajtja investive e rrugëve nacioanle dhe rajonale të Kosovës për vitin 2022 - Lot 2” si dhe një pagesë e ekzekutuar nga Thesari që kishte të bënte me shpronësimin e tokave. Projektet që vazhdojnë të mbahen si investime në vijim: 1. “Zgjerimi i rrugëve Brahim Ademi dhe Driton Islami”- pranimi teknik në qershor 2019, 2. “Ndërtimi i rrugës Vojnik-Osojan Lot 2” - pranimi teknik në nëntor 2018 si dhe 3. “Zgjerimi i rrugës rajonale R102, segmenti Komoran-Morinë L=17km, Lot 2 (Marinë-Tërstenik) L=2.995m” - pranimi teknik në nëntor 2019.
- <sup>6</sup> 1. Kontrata për “Mirëmbajtjen verore dhe dimërore e autoudhës A7 (Ibrahim Rugova) Llot 2” me çmim për njësi 123,262.41, në pesë (5) pozicione sasia/vlera e parashikuar për pozicion ishte tejkualuar për 142,875€ (në vlerë të përbashkët). 2. Kontrata për “Mirëmbajtjen verore dhe dimërore e autoudhës A7 (Ibrahim Rugova) Llot 1” me çmim për njësi 138,953.44€, në katër (4) pozicione sasia/vlera e parashikuar për pozicion ishte tejkualuar për 131,656€ (në vlerë të përbashkët). 3. Kontrata për “Mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për vitet 2022 2023, 2023 2024 dhe 2024 2025, Regjioni Mitrovica1- Lot 4” me çmim për njësi 29,312.04€, në 39 pozicione sasia/vlera e parashikuar për pozicion ishte tejkualuar për 172,562€ (në vlerë të përbashkët). 4. Kontrata për “Mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për vitet 2022 2023, 2023 2024 dhe 2024 2025, Regjioni Prizren 1- Lot 8” me çmim për njësi 35,221.93€, në 14 pozicione sasia/vlera e parashikuar për pozicion ishte tejkualuar për 44,043€ (në vlerë të përbashkët). 5. Kontrata për “Mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për vitet 2022 2023, 2023 2024 dhe 2024 2025, Regjioni Gjilan 1- Lot 12” me çmim për njësi 32,179.87€, në 28 pozicione sasia/vlera e parashikuar për pozicion ishte tejkualuar për 158,583€ (në vlerë të përbashkët). 6. Kontrata për “Mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për vitet 2022 2023, 2023 2024 dhe 2024 2025, Regjioni Prizren 2- Lot 9” me çmim për njësi 66,036.35€, në 13 pozicione sasia/vlera e parashikuar për pozicion ishte tejkualuar për 53,136€ (në vlerë të përbashkët). 7. Kontrata për “Mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për vitet 2022 2023, 2023 2024 dhe 2024 2025, Regjioni Peja 2- Lot 7” me çmim për njësi 58,908.64€, në 22 pozicione sasia/vlera e parashikuar për pozicion ishte tejkualuar për 99,697€ (në vlerë të përbashkët). 8. Kontrata për “Mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për vitet 2022 2023, 2023 2024 dhe 2024 2025, Regjioni Prishtina 1- Lot 1” me çmim për njësi 19,729.12€, në 22 pozicione sasia/vlera e parashikuar për pozicion ishte tejkualuar për 166,361€ (në vlerë të përbashkët). 9. Kontrata për “Mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për vitet 2022 2023, 2023 2024 dhe 2024 2025, Regjioni Gjakova 1- Lot 14” me çmim për njësi 74,368.43€, në 34 pozicione sasia/vlera e parashikuar për pozicion ishte tejkualuar për 100,591€ (në vlerë të përbashkët). 10. Kontrata për “Mirëmbajtje verore dhe dimërore të rrugëve Nacionale dhe Rajonale të Kosovës për vitet 2022 2023, 2023 2024 dhe 2024 2025, Regjioni Mitrovica - Lot 2” me çmim për njësi 6,814€, në 19 pozicione sasia/vlera e parashikuar për pozicion ishte tejkualuar për 122,611€ (në vlerë të përbashkët).
- <sup>7</sup> Neni 35.3: Ekzekutimi i një procedure të negociuar pa publikimin e njoftimit të kontratës në asnjë mënyrë nuk e liron autoritetin kontraktues nga detyrimi i tij që (i) të luajë një rrol aktiv në përcaktimin e kushteve të kontratës, veçanërisht sa ka të bëjë me çmimet, afatet e pranimit, sasi të, karakteristikat teknike dhe garancionet, (ii) të sigurojë që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi përkatës i tregut, dhe (iii) të vlerësojë me kujdes kualitetin e produktit, shërbimit ose punës në fjalë.
- <sup>8</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>9</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>10</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.